



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 6-24/2024 regjistër (JR)
Datë 09.04.2026

Nr. 70 i vendimit
Datë 03.06.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Mimoza Tasi	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, ditën e mërkurë, më datë 03.06.2026, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen që i përket:

KËRKUES: Artan Hajredinaj, me adresë rruga “{***}”, Njësia Administrative Nr. {***}, Tiranë, me adresë elektronike e-mail: {***}. Përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. {***}rep., nr. {***} kol., datë 08.04.2026, nga zyra ligjore “{***}” ShPK, me nr. NUIS {***}, me administrator avokatin E. B..

OBJEKTI:

1. Rishikimi i Vendimit nr. 39, datë 14.05.2025, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, marrë në bazë të ligjit të posaçëm nr. 84/2016 “*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, përmes së cilit kërkuesit i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë “*E drejta për një proces të drejtë gjyqësor*” dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore “*E drejta për një proces të rregullt*”.
2. Prishjen tërësisht të vendimit nr. 39, datë 14.05.2025 dhe gjykimin e çështjes në themel (neni 498 i K.Pr.C).

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, pika 1, 5, 6, 7, 15, 42, 116, pika 1, 122 dhe 124 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, miratuar në Strasburg më 1950, ratifikuar nga

Republika e Shqipërisë në vitin 1995; nenet 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, analizoi pretendimet e kërkuarit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit të saj, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Z. Artan Hajredinaj (në vijim “kërkuesi”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, sipas përcaktimeve të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, (në vijim “ligji nr. 84/2016”). Pas hetimit administrativ të zhvilluar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 744, datë 19.03.2024, ka vendosur: *“Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Artan Hajredinaj, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë [...]”*.
2. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankimi¹ nga Komisioneri Publik në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), i cili, me vendimin nr. 39, datë 14.05.2025, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 744, datë 19.03.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artan Hajredinaj”*.
3. Kolegji e ka mbështetur këtë vendim në nenin D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.
4. Kërkuesi Artan Hajredinaj më datën 09.04.2026 ka depozituar², në Kolegji, kërkesën për rishikimin e vendimit të sipërcituar, e regjistruar në Kolegji si çështja me nr. 6-24/2024 (JR).

II. Pretendimet e kërkuarit

5. Kërkuesi në kërkesën e tij pretendon se vendimi i Kolegjit është marrë në kushtet e një vlerësimi të paplotë dhe jo gjithëpërfshirës të rrethanave faktike dhe provave të disponueshme, si dhe në mungesë të administrimit të një prove të re³ me karakter vendimtar, e cila ka qenë objektivist e panjohur dhe e paarritshme gjatë zhvillimit të gjykimit.
6. Kërkuesi pretendon se vendimi i Kolegjit ka sjellë cenim të të drejtave dhe lirive themelore të tij, konkretisht të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe për një gjykim të drejtë, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës

¹ Ankim i Komisionerit Publik nr. {***} prot., datë 14.06.2024, protokolluar në Kolegji nr. {***} prot., datë 18.06.2024.

² Protokolluar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 09.04.2026.

³ Bashkëlidhur kërkesës për rishikim, kërkuesi ka depozituar aktet e mëposhtme: (i) Prokurë e Posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.04.2026; (ii) kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 18.03.2026, i zyrës përmbarimore, shoqëruar me dokumentacion; (iii) Dosja Përmbarimore nr. {***} Regj., datë 19.05.2015, për ekzekutimin e Urdhërit të Ekzekutimit nr. {***}, datë 12.01.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, lidhur me pasuritë nr. {***} dhe nr. {***} lloji “vreshtë”, vendndodhja “{***}”, Tropojë, të shitura shtetasit A. H. (gjithsej 124 fletë).

Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNJ”). Sipas tij, ky cenim nuk lidhet thjesht me rezultatin e vendimmarrjes, por me vetë mënyrën e formimit të bindjes gjyqësore, e cila, në mungesë të një elementi thelbësor provues, nuk ka mundur të pasqyrojë në mënyrë të plotë dhe objektive realitetin faktik të çështjes.

7. Kërkuesi e mbështet kërkesën e tij në nenin 494, germa “a” të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon: *“Zbulohen rrethana të reja apo provave të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj”*. Prova e re me shkresë mbi të cilën mbështetet kërkesa e paraqitur konsiston në tërësinë e dokumentacionit⁴ të praktikës përmbarimore nr. {***} regj., të regjistruar më datë 19.05.2015, pranë shoqërisë Përmbarimore “{***}” ShPK, nga përmbaruesi gjyqësor A. L., me objekt ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit nr. {***}, datë 12.01.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.
8. Kërkuesi pretendon se në kuptim të përmbarimit të kushteve të germës “a” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, këto akte përbëjnë dokumente zyrtare, të lëshuara nga organet kompetente shtetërore dhe subjekte të licencuara, të cilat mbajnë elementet formalë të vlefshmërisë dhe autenticitetit, duke përmbarur pa asnjë dyshim kriterin e “provës me shkresë”, në kuptim të nenit 174 të Kodit të Procedurës Civile.
9. Sa i përket pamundësisë objektive për njohjen dhe paraqitjen e provës gjatë gjykimit, kërkuesi pretendon se nuk ka qenë dhe nuk mund të ishte në dijeni për shkak të natyrës së saj specifike dhe faktit se ajo ndodhej në administrimin e një subjekti të tretë, përmbaruesit gjyqësor për një praktikë përmbarimore të zhvilluar vite më parë. Kërkuesi pretendon se ka ardhur në dijeni të ekzistencës së kësaj prove vetëm pas shpalljes së vendimit të Kolegjit dhe, konkretisht, pas njohjes me arsyetimin e plotë të tij, ku nëpërmjet paraqitjes nga kërkuesi të një kërkesë pranë zyrës përmbarimore është bërë i mundur sigurimi i dokumentacionit, vënë në dispozicion me shkresën nr. {***} prot., datë 18.03.2026, të zyrës përmbarimore.
10. Sa i përket rëndësisë vendimtare të provave të reja, kërkuesi pretendon se ajo lidhet drejtpërdrejt me një nga shtyllat kryesore të arsyetimit të vendimit të Kolegjit, atë të kriterit të vlerësimit të pasurisë, konkretisht me interpretimin e diferencës së çmimeve në transaksionet e pasurive të ndodhura në qytetin e Bajram Currit dhe me konkluzionin mbi mungesën e burimeve financiare të ligjshme të kërkuesit. Për pasojë, sipas kërkuesit, kjo provë ka një rëndësi thelbësore, direkte dhe përcaktuese në zgjidhjen e çështjes, ka potencialin të ndryshojë në mënyrë rrënjësore analizën financiare të Kolegjit, mbi të cilën është ndërtuar konkluzioni për mungesë të burimeve të ligjshme, duke rrëzuar premisën kryesore faktike të vendimit objekt rishikimi.
11. Sipas kërkuesit, konkluzionet e Kolegjit se transaksionet e shitjes së pasurive nr. {***} dhe nr. {***}, të ndodhura në qytetin e Bajram Currit në favor të shtetasit A. H. janë të dyshimta, ekonomikisht të paarsyeshme dhe potencialisht fiktive, duke sjellë si pasojë mungesën e burimeve të ligjshme në kuptim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, rrëzohen në mënyrë të drejtpërdrejt nga provat e reja. Sipas tij, ky dokumentacion provon në mënyrë të qartë se

⁴ Vendimi nr. {***}, datë 12.01.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë; kontrata e huasë dhe hipotekës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.06.2012; vendimi për caktimin e ekspertit i datës 21.07.2015; si dhe raporti i vlerësimit i muajit korrik 2015.

shtetasi A. H. ka ushtruar të drejta pronësore reale, efektive dhe juridikisht të plota mbi pasurinë nr. {***}, pasi më datë 29.06.2012, rreth gjashtë vite pas blerjes së pasurisë nga kërkuesi, ky shtetas, në cilësinë e pronarit legjitim, ka vendosur hipotekë mbi këtë pasuri për garantimin e një detyrimi kreditor.

12. Gjithashtu, sipas kërkuesit, një provë tjetër që rrëzon analizën e Kolegjit mbi çmimin dhe burimet financiare është edhe raporti i vlerësimit i hartuar nga eksperti i licencuar F. Z. (licencë {***}), nën mbikëqyrjen e Dr. B. M. (licencë {***}). Në kushtet kur ky raport ka përcaktuar vlerën e tregut të lirë të pasurisë nr. {***}, me sipërfaqe 5.586,4 m², në shumën 2.000.000 (dy milionë) lekë, në vitin 2015, atëherë sipas tij edhe pasuria tjetër 1/1, me sipërfaqe 12.117 m², e cila është më shumë se dyfishi i sipërfaqes duhet të ketë një vlerë proporcionale dukshëm më të lartë, në intervalin minimal prej 4.000.000 deri në 5.000.000 lekësh. Për rrjedhojë, sipas kërkuesit, *vlera e kombinuar e të dy pasurive në vitin 2015 rezulton në një interval rreth 6.000.000 deri në 7.000.000 lekë, në një treg të ulur dhe jo favorizues.*
13. Në këtë kuptim, kërkuesi kërkon që çmimi i shitjes i realizuar për këto pasuri në tetor të vitit 2006, në shumën prej 12.392.800 lekësh, duhet të vlerësohet në raport me një treg krejtësisht të ndryshëm ekonomik, në kulmin e zhvillimit të tregut të pasurive të paluajtshme gjatë viteve 2006-2007. Sipas kërkuesit, raporti i ekspertit, jo vetëm që e bën të arsyeshëm çmimin e vitit 2006, por e konfirmon atë si plotësisht konsistent me logjikën ekonomike dhe vlerën reale të tregut në atë periudhë.
14. Kërkuesi pretendon se provat e reja zbehin në mënyrë të konsiderueshme edhe argumentin e Kolegjit, lidhur me mungesën e gjurmës bankare për pagesën e çmimit të shitjes, pasi veprimet e mëvonshme të blerësit të kësaj pasurie, shtetasi A. H., përbëjnë një zinxhir veprimesh juridike të mundshme vetëm në kushtet e një pronësie reale dhe efektive, e cila presupozon domosdoshmërisht ekzistencën e një transaksioni të vlefshëm dhe të realizuar. Kërkuesi pretendon se provat e reja, jo vetëm që plotësojnë, por përmbysin analizën e Kolegjit, mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke krijuar një bazë të re faktike që imponon rishqyrtimin e vendimit objekt kërkese.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Procesi gjyqësor në Kolegj

Juridiksioni i Kolegjit

15. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.
16. Në vijim të sa më sipër, rezulton se i gjithë kuadri kushtetues dhe ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit nuk ka asnjë parashikim të shprehur literal, *së pari*, për të drejtën procedurale të paraqitjes së kërkesës për rishikim të subjekteve të rivlerësimit brenda kuadrit të zhvillimit të këtij procesi dhe, *së dyti*, as për ndonjë kompetencë të Kolegjit që ushtrohet tej funksionit kontrollues të vendimeve të Komisionit në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, mbi bazën e ankimeve të paraqitura nga subjektet dhe Komisioneri Publik.

17. Për shkak të kësaj baze ligjore dhe jurisprudencës së Kolegjit, trupi gjykues, lidhur me kërkimin në rastin konkret, nënvizon qëndrimin se Kolegji mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNj”), në përgjigje të ankimit të vetë kërkuesit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së.
18. Trupi gjykues, pasi analizoi përmbajtjen e kërkesës për rishikim, konstatoi se ajo bazohej në nenin 494, shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, referim i cili përcaktoi edhe analizën e trupit gjykues që i atribuohet këtij shkak rishikimi. Në vijim të arsytimit mbi juridiksionin e Kolegjit, trupi gjykues sjell në vëmendje vendimin nr. 12, datë 19.04.2024, të Kolegjit, që i përket kërkesave për rishikim të kërkuesit A. Y., në të cilin është arritur në konkluzionin se dispozitat e Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar, parashikojnë dhe përcaktojnë në mënyrë të shprehur vetëm juridiksionin rivlerësues të Kolegjit, lidhur me kontrollin ndaj vendimeve të marra prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, juridiksion i ushtruar mbi ankimin e subjekteve të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik. Më tej, në këtë vendim, është arsyetuar se nga analiza e kuadrit rregullator të posaçëm nuk rezulton të ketë asnjë parashikim eksplicit për ushtrimin e juridiksionit rishikues të Kolegjit, sipas kërkesës së parashikuar prej kërkuesit, në çështjen objekt shqyrtimi. Mungesa e një parashikimi të tillë në ligjin e posaçëm, e shoqëruar edhe me mungesën e rregullave për trajtimin e kërkesave të tilla, diktoi nevojën e analizimit nga trupi gjykues i çështjes së cituar më sipër, të dispozitave që thirren për zbatim nga ligji nr. 84/2016, nëse nëpërmjet tyre mund të ushtrohej ky juridiksion rishikues i pretenduar nga kërkuesi.
19. Në vijim të sa më sipër, në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, nuk parashikohet në mënyrë të shprehur asnjë rregull për institutin e rishikimit, si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, duke ndjekur të njëjtën logjikë, në zbatim të nenit 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, sipas së cilit dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.
20. Në vendimin e referuar më sipër, është marrë në analizë, nëse ndërtimi i këtij mekanizmi kontrolli të jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë vjen në përputhje me qëllimin e legjislatorit edhe në rastin konkret, lidhur me tagrat e atribuuar organeve të rivlerësimit dhe posaçërisht Kolegjit. Në këtë vendim, por edhe në vendimet e marra më pas, që kanë shqyrtuar kërkesa të ngjashme për rishikimin e vendimeve të tij⁵, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka arritur në konkluzionin se nuk ka juridiksion rishikues si një prej tagrave të tij dhe nuk është ngritur për t’i dhënë jetë këtij instituti procedural, sipas rregullimeve të përgjithshme të tij, parashikuar në nenet 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.
21. Në zbatim të parashikimit të nenit 116, pika 1, germa “b” e Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara bëjnë pjesë në aktet normative që kanë fuqi në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke u renditur në hierarkinë e ligjeve pas Kushtetutës së vendit. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, së bashku me mekanizmat e saj zbatues, garanton zbatimin e parimit të procesit të rregullt ligjor nga gjykatat e brendshme, por edhe të parimeve të tjera që parashikon Konventa, në përputhje me nenet 17 e 42 të Kushtetutës. Parashikimi i

⁵ Vendimi i Kolegjit nr. 9, datë 28.02.2025; vendimi nr. 10, datë 28.02.2025; vendimi nr. 18, datë 08.05.2025; vendimi nr. 19, datë 08.05.2025.

nenit F, pika 8⁶ e Aneksit të Kushtetutës, konsiderohet si i vetmi mjet procedural që kanë në dispozicion subjektet e rivlerësimit, për të korrigjuar shkeljet nga Kolegji në gjykimin e çështjeve të tyre. Ky parashikim i drejton subjektet drejt GjEDNj-së, duke konfirmuar natyrën e jashtëzakonshme të procesit të rivlerësimit, në raport me rregullat e zakonshme procedurale. Si rrjedhojë, subjektet e rivlerësimit kanë të drejtë të ankimojnë vendimet e Kolegjit në GjEDNj, për çdo rast që ata konsiderojnë se vendimmarrja ndaj çështjes së tyre të rivlerësimit është në shkelje të parashikimeve të Konventës dhe Protokolleve të saj, të mbrojtura në Kushtetutë, për shkak të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare që edhe Shqipëria është palë.

22. Në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, në germën “ë”, parashikohet se pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë *kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.* Kushtetuta në nenin 122 përcakton epërsinë e marrëveshjeve ndërkombëtare në rendin juridik të brendshëm dhe sjell si detyrim që vendimet e GjEDNj-së të zbatohen drejtpërsëdrejti nga të gjithë organet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, përfshirë gjykatat e të gjithë niveleve, po ashtu, edhe gjykatat me juridiksion specifik siç është Kolegji. Si rrjedhojë, nga leximi harmonik i nenit 179/b të Kushtetutës, nenit F të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji do të kishte juridiksion rishikues vetëm mbi bazë të një vendimi të GjEDNj-së që potencialisht do të konstatonte se ekzistojnë shkaqet që përlligjin shqyrtimin e një vendimi të formës së prerë të tij, nëpërmjet rihapjes së procesit, për të rivendosur të drejtën e cenuar.
23. Në këto kushte, trupi gjykues, pa përsëritur arsyetimet e përdorura në raste tjera të ngjashme⁷, si dhe duke ndjekur të njëjtën analizë sistematike të dispozitave Kushtetuese dhe ligjore, dhe sipas orientimeve të instrumenteve ndërkombëtare, që normojnë parimet mbi të cilat zhvillohet edhe procesi i rivlerësimit kalimtar, rikonfirmon vlerësimin që në kushtet që nuk ka një vendim, nëpërmjet të cilit GjEDNj-ja të ketë konkluduar për shkelje të kryer në procesin e rivlerësimit të kërkuarit, kërkesa e tij për rishikim nuk mund të shqyrtohet nga Kolegji, për shkak të mospasjes prej tij të juridiksionit rishikues, sipas referimeve që kërkuari bën në nenin 494, germa “a” të Kodit të Procedurës Civile.
24. *Së fundmi*, ndonëse shkak i rishikimit i paraqitur prej kërkuarit nuk i nënshtrohet juridiksionit rishikues të Kolegjit, sipas arsytimit të mësipërm, sërish ai, sipas një analize *obiter dictum* të trupit gjykues, konstatohet se edhe nëse do t’i nënshtrohej shqyrtimit gjyqësor do të konsiderohej i pabazuar në fakte dhe në ligj, pasi pretendimet e kërkuarit të paraqitura në kërkesën e tij nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në nenin 494, germa “a” të Kodit të Procedurës Civile, sipas së cilit duhet të plotësohen tre kushte kumulative për t’i dhënë udhë rishikimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë: (i) dalja e rrethanave apo provave të reja; (ii) këto rrethana apo prova të reja nuk dihen dhe as nuk mund të dihen nga pala apo gjykata gjatë gjykimit; (iii) të kenë rëndësi esenciale për zgjidhjen e çështjes.

⁶ Subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

⁷ Vendimi nr. 12, datë 19.04.2024, i Kolegjit, që u përket kërkesave për rishikim të kërkuarit A. Y.; vendimi nr. 9, datë 28.02.2025, i Kolegjit, që i përket kërkesës për rishikim të kërkuarit A. B.; vendimi nr. 10, datë 28.02.2025, i Kolegjit, që i përket kërkesës për rishikim të kërkuarit B. M..

25. Lidhur me kushtin e parë që lidhet me provat e reja të sjella nga kërkuesi, bashkëlidhur kërkesës së tij për rishikim, trupi gjykues konstaton se ato nuk janë administruar në procesin e rivlerësimit të kërkuesit. Konkretisht sa i përket praktikës përbarimore nr. {***} regj., regjistruar më datë 19.05.2015, pranë shoqërisë Përbarimore “{***}” ShPK, si dhe dokumentacionit përbërës të saj, konstatohet se ato i përkasin një periudhe disaveçare, para se të fillonte procesi i tij i rivlerësimit kalimtar dhe shumë vite pasi kërkuesi ka nënshkruar kontratat e shitblerjes⁸ për pasuritë nr. {***} dhe nr. {***}, të ndodhura të qytetin e Bajram Currit.
26. Lidhur me kushtin e dytë që prova apo rrethana e re, jo vetëm nuk dihej nga pala gjatë gjykimit, por edhe nuk ekzistonte mundësia objektive e dijenisë mbi të, trupi gjykues vlerëson se mungesa e dijenisë lidhet me pamundësinë objektive dhe jo subjektive të kërkuesit për të gjetur provat me të cilat do të provojë pretendimet e tij. Nga aktet e dosjes së procesit të rivlerësimit për kërkuesin, rezulton se Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për fiktivitetin e çmimit të blerjes dhe shitjes së pasurive nr. {***} dhe nr. {***}, të ndodhura të qytetin e Bajram Currit, në muajin shkurt të vitit 2024. Komisioneri Publik, në ankimin e paraqitur në Kolegj më datë 14.06.2024, konkretisht në pikën 14.9.2 të ankimit, ka ngritur pikërisht si shkak ankimi të ardhurat e pretenduara nga këto pasuri, duke evidentuar diferencat e larta të çmimeve në blerje dhe shitje. Kësisoj kërkuesi ka qenë në dijeni të problematikës së konstatuar dhe ka pasur të gjithë kohën e mjaftueshme për t’i kundërshtuar ato nëpërmjet paraqitjes së provave, aq më tepër që prova e pretenduar nga kërkuesi si provë e re i përket një dosje përbarimore të vitit 2015. Kërkuesi i kishte të gjitha lehtësitë dhe mundësitë për t’i gjetur, nëse do të tregonte kujdesin e duhur gjatë procesit të rivlerësimit dhe mjafton t’i drejtohej me kërkesë zyrës përbarimore, sikurse e ka bërë nëpërmjet kërkesës drejtuar prej vetë atij në datën 18.03.2026, pasi kishte përfunduar gjykimi në Kolegj.
27. Trupi gjykues çmon se kërkesa për rishikimin e vendimit nuk mund të shërbejë si mjet për rihapjen e procesit, kur kërkuesi ka ometuar për faj të tij, në përmbushjen e barrës së provës gjatë gjykimit apo gjen prova që objektivisht mund dhe duhet t’i kishte paraqitur gjatë procesit të rivlerësimit. Pretendimi i subjektit se ndodhej në pamundësi objektive për ta administruar këtë provë, përpara apo gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit, nuk qëndron. Për pasojë dhe në këtë këndvështrim, rrethana e pretenduar nuk plotëson kriteret e nenit 494 germa “a” e Kodit të Procedurës Civile.
28. Lidhur me kushtin e tretë, që ka të bëjë me ndikimin e provës së re për çështjen, trupi gjykues konstaton se aktet e paraqitura nga kërkuesi nuk kanë peshë lidhur me konstatimet e Kolegjit në arsyetimin e vendimit, për të cilin kërkohet rishikimi, për arsye se: (i) fiktiviteti është konstatuar vetëm lidhur me çmimin e transaksioneve të shitblerjes dhe jo me efektet e kalimit të pronësisë; (ii) vlera që kanë pasur pasuritë në vitin 2015 nuk mund të justifikojë çmimet e vendosura në kontratat e shitblerjes në vitin 2006. Në këtë kuptim, raportin e vlerësimit të ndodhur në dosjen përbarimore, të cilën kërkuesi e ka sjellë bashkë me kërkesën për rishikim, si provë në Kolegj, ku paraqitet vlera e tregut të lirë në vitin 2015 e pasurisë nr. {***}, me

⁸ Nga aktet e dosjes së Komisionit, ka rezultuar se me kontratë shitblerje nr. {***}, datë 08.06.2006, Artan Hajredinaj, i ka blerë shtetas H. S. pasurinë nr. {***}, lloji tokë vresht, me sip. 12.117 m², në vlerën 1.000.000 lekë, pasuri të cilën pas 4 muajsh subjekti ia ka shitur shtetasit Avni Hajdarmataj me kontratë nr. 3588/357, datë 09.10.2006, në vlerën 8.481.900 lekë. Me kontratë shitblerje nr. {***}, datë 08.06.2006, Artan Hajredinaj i ka blerë shtetas H. S. pasurinë nr. {***}, lloji tokë vresht me sip. 5.586,4 m², në vlerën 500.000 lekë, pasuri të cilën pas 4 muajsh subjekti ia ka shitur shtetasit A. H. në vlerën 3.910.900 lekë.

sipërfaqe 5.586,4 m², në shumën 2.000.000 (dy milion) lekë, trupi gjykues e vlerëson pa impakt në trajtimin e kësaj çështjeje, për sa kohë ky akt është hartuar në vitin 2015, disa vite më vonë nga hartimi i kontratës së shitblerjes në vitin 2006 dhe nuk pasqyron të dhëna që të justifikojnë veprimet juridike të kërkuarit me këto pasuri.

29. Pretendimi i kërkuarit për një vlerësim të çmimeve të këtyre pasurive, bazuar në vlerën e tregut të kohës, bie në kundërshtim me vetë veprimet e kryera prej tij, i cili brenda një periudhe të shkurtër kohore ka blerë këto pasuri (më 08.06.2006), në vlerën 1.500.000 lekë, duke i shitur pas katër muajsh, (më 09.10.2006), me një diferencë ndjeshëm më të lartë, për vlerën 12.392.800 lekë. Gjithashtu, aktet e sjella në kërkesën për rishikim nuk arrijnë të kundërshtojnë konstatimin e Kolegjit për mungesën e gjurmëve për përfitimin e të ardhurave nga kjo shitje, si transaksion bankar apo faturë/mandatpagesë.
30. Në përfundim të analizës së mësipërme trupi gjykues arriti në përfundimin se kërkesa e paraqitur nga z. Artan Hajredinaj, është e pabazuar në fakte dhe në ligj dhe, për pasojë, ajo konsiderohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji, bazuar në nenin 498, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile,

V E N D O S I:

Mospranimin e kërkesës të kërkuarit Artan Hajredinaj, për rishikimin e vendimit nr. 39, datë 14.05.2025, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 03.06.2026.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Mimoza TASI

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, jam dakord me zgjidhjen e çështjes për vendimin nr. 70, datë 03.06.2026, për çështjen nr. 6-24/2024 regjistër (JR) datë 09.04.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur mospranimi i kërkesës së kërkuarit Artan Hajredinaj, për rishikimin e vendimit nr. 39 (JR), datë 14.05.2025, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, por kam mendim paralel, lidhur me arsyetimin e shumicës së trupit gjykues, për sa parashtruar në vijim.
2. Trupi gjykues në përfundim ka konkluduar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të vetë kërkuarit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislati brendshëm, për t’u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.
3. Në ndryshim nga shumica, në analizë harmonike të dispozitave kushtetuese, ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji “nr. 84/2016”) dhe legjislati në fuqi, kam vlerësuar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka juridiksion rishikues për të shqyrtuar kërkesat për rishikim bazuar në të gjitha rrethanat e parashikuara të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile. Ky qëndrim bazohet në argumentet e referuara prej meje në mendimin paralel për kërkesat për rishikim të paraqitura nga kërkuari A. Y.⁹.
4. Sa i përket shkaqeve të rishikimit të paraqitura në kërkesën e z. Artan Hajredinaj, kam ndarë të njëjtin qëndrim si edhe pjesa tjetër e trupit gjykues, të pasqyruar në paragrafët 25 deri 29 të vendimit, duke i konsideruar ato të pabazuara mbi të njëjtat argumente, duke vendosur mospranimin e tyre.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

⁹ Shiko mendimin paralel në vendimin nr.12, datë 19.04.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendim-JR-A.-Y._perfshire-mendimet-paralele_anonimizuar_word-1.pdf

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e kryesueses, jam dakord me zgjidhjen e çështjes në vendimin nr. 70, datë 03.06. 2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit Artan Hajredinaj për rishikimin e vendimit gjyqësor nr. 39 (JR), datë 14.05.2025, të Kolegjit, me të cilin është vendosur mospranimi i kërkesës, por kam ndarë mendim ndryshe sa i përket qëndrimit të mbajtur lidhur me arsyetimin për mungesën e juridiksionit rishikues¹⁰ të Kolegjit për shqyrtimin e kërkesave që nuk kanë një vendim të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas shkronjës “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.
2. Në vlerësimin tim, Kolegji ka juridiksion rishikues për shqyrtimin e kërkesave për rishikim vendimi që janë paraqitur bazuar në nenin 494¹¹, shkronja “c”¹² të Kodit të Procedurës Civile dhe argumentet e mia kundërshtuese për mungesën e juridiksionit rishikues, janë shprehur në mënyrë shteruese dhe konsistente në një sërë vendimesh ku janë shqyrtuar kërkesat për rishikim vendimi, duke mbajtur një qëndrim ndryshe, shprehur nëpërmjet mendimeve të pakicës apo mendimeve paralele¹³.
3. Një interpretim nga Kolegji që pranon rishikimin vetëm pas vendimit të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të kërkuarit (subjekt rivlerësimi), e bën juridiksionin rishikues të varur vetëm nga gjykata e Strasburgut, duke hequr mundësinë e çdo mekanizmi korrigjues të brendshëm dhe duke krijuar një vakum juridik për shkelje serioze që nuk kanë arritur ende në GjEDNj.
4. Pranimi i juridiksionit rishikues vetëm në mënyrë minimaliste dhe vetëm për vendimet e GjEDNj-së, në vlerësimin që i bëj çështjes, duket se krijon një kontradiktë logjike, sepse e bën rishikimin një “mjet të jashtëm” dhe jo “mjet të brendshëm”, duke lënë pa zgjidhje gabimet serioze të brendshme që përbëjnë shkaqet e rishikimit sipas shkronjave të tjera të nenit 494 të Kodit. Pra, nëse rishikimi do të ekzistojë vetëm pasi GjEDNj-ja të shprehet me një vendim të posaçëm për kërkuarin (subjekt rivlerësimi), kjo do të passillte që mjete i brendshëm të mos jetë efektiv¹⁴ dhe kjo mund të çojë në shkelje të nenit 13¹⁵ të KEDNj-së.

¹⁰Ky qëndrim është mbajtur nga shumica e trupës gjyqësore në vendimin nr. 12, datë 19.4.2024, që ka shqyrtuar kërkesën e kërkuarit A. Y., regjistruar me nr. 2-4/2019 regjistër (JR), datë 10.1.2022, me objekt “Rishikimi i vendimit të formës së prerë nr. 31 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, në të cilin nuk kam qenë anëtare e trupit gjyqësor.

¹¹Neni 494 i KPrC: “Kërkesa për rishikim është akti me të cilin kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur: ë...](c) palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjyqësor, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit; ë...] (ë) kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirisë themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

¹²Në vendimin e Kolegjit nr. 34, datë 06.12.2023, që i përket kërkuarit R. G., me mendim paralel, jam shprehur që kërkesa e katërt, për rishikimin e vendimit nr. 12/2019 të Kolegjit, sipas shkronjës “c” të nenit 494, është e bazuar dhe përbën shkak për rishikimin e vendimit përfundimtar.

¹³Vendimi i Kolegjit nr. 9, datë 28.2.2025, që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit A. B.; Vendimi i Kolegjit nr. 18, datë 8.5.2025, që i përket shqyrtimit të kërkesave të kërkuarit A. Gj., etj.

¹⁴Çështja “Scordino v. Italy (No. 1) (GC, 2006) (Application no. [36813/97](https://hudoc.echr.coe.int/eng/?i=001-72925)) - <https://hudoc.echr.coe.int/eng/?i=001-72925>”.

¹⁵Neni 13 i KEDNj-së: “Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

5. Në lidhje me kërkesën e kërkuarit Artan Hajredinaj, paraqitur në Kolegj më datë 09.04.2026, të cilën e ka mbështetur në nenin 494, shkronja "a" të Kodit të Procedurës Civile dhe pretendimet e parashtruara në për daljen e një prove të re me karakter vendimtar, e cila ka qenë objektivist e panjohur dhe e paarritshme gjatë zhvillimit të gjyqimit të çështjes së tij të rivlerësimit në Kolegj, ndaj që njëjtin qëndrim me shumicën e trupit gjykues.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, jam dakord me vendimin nr. 70 (JR), datë 03.06.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për: Mospranimin e kërkesës së kërkuarit Artan Hajredinaj, me nr. {***} prot., datë 09.04.2026, me objekt rishikimin e vendimit nr. 39/2025 (JR), datë 14.05.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, por me një arsyetim ndryshe, lidhur me arsyet se përse kjo kërkesë për rishikim nuk duhet pranuar nga Kolegji, sipas parashikimeve të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Siç shihet edhe nga arsyetimi i shumicës në vendim, është përdorur e njëjta linjë arsyetimi në lidhje dhe me çështjet e tjera që u përkasin kërkesave për rishikim të vendimeve të juridiksionit të rivlerësimit. Më konkretisht, jam kundër arsyetimit të shumicës [...] *për t’i dhënë përgjigje përfundimtare kërkesës së paraqitur prej kërkuarit Artan Hajredinaj, për të cilin GjEDNj-ja nuk ka marrë ende një vendim, ndaj kjo kërkesë nuk mund të shqyrtohet nga Kolegji, për shkak të mospasjes prej tij të juridiksionit rishikues, sipas referimeve që kërkuari bën në nenin 494, germa “a” e Kodit të Procedurës Civile. Sipas analizës së dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si dhe referuar jurisprudencës së Kolegjit, trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të vetë kërkuarit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së [...].*
3. Unë, gjyqtarja me mendim paralel, vlerësoj se në kushtet kur Kushtetuta dhe ligji nuk i ka atribuar Kolegjit juridiksion rishikues, ndaj mendimin se ky institucion nuk mund të ushtrojë këtë tagër/rishikim ndaj vendimeve të tij, kështu që mbetet detyrë pikërisht e ligjvënësit, në kuadër të nenit 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për të rregulluar këtë situatë të krijuar, duke rishikuar kuadrin ligjor aktual, me qëllim përfshirjen e parashikimeve ligjore, duke përcaktuar gjykatën kompetente dhe procedurat ligjore respektive për kryerjen e rishikimit të vendimeve të Kolegjit, të kërkuara nga subjektet e rivlerësimit.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi